

VENDIM
Nr.678, datë 18.6.2009

PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË DISA OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË TEKSTILEVE TË PAMBUKTA, NË TIRANË, TË NDËRMARRJES MEKANIKE-TEKSTILI, TIRANË, DHE TË ISH-SHKOLLËS SË PARTISË, TIRANË

(Ndryshuar me VKM nr. 367, datë 18.4.2013)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objektet e ish-kombinatit të tekstileve të pambukta, Tiranë, të ndërmarrjes mekanike-tekstili, Tiranë, të ish-shkollës së partisë, Tiranë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, t’i kalojnë Entit Kombëtar të Banesave për fond banesash.

2. Enti Kombëtar i Banesave të bëjë kalimin në pronësi, pa kundërshtpërblim, të këtyre objekteve, për personat, të cilët i kanë aktualisht në përdorim.

3. Enti Kombëtar i Banesave të bashkëpunojë me ish-kombinatit të tekstileve të pambukta, Tiranë, me ndërmarrjen mekanike-tekstili, Tiranë, dhe njësinë bashkiake nr.11, Tiranë, për saktësimin e listave përkatëse.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Enti Kombëtar i Banesave, njësia bashkiake nr.11, Tiranë, dhe ish-kombinati i tekstileve të pambukta, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NDËRMARRJA MEKANIKE E TEKSTILIT TIRANË
LISTA E INVENTARIT TË OBJEKTEVE TË UZINËS MEKANIKE
TEKSTILIT TIRANË

Nr.	Emërtimi i objekteve	Vitet		Vlera fillestare sipas kontabilitetit (000 lekë)	Sipërfaqja totale e objektit m ²	Shënim
		E ndërtimit	E vënies në shfrytëzim			
1	Impianti i ftohjes nr.1	1983	1985	1119.9	432	
2	Impianti i ftohjes nr.2	1983	1986	1680.0	644	
3	Magazina e detaleve	1954	1954	123.0	192	

4	Stacioni i pompimit të ujërave të zeza	1951	1951	357	176	
	TOTALI			3279.9	1444	

LISTA E OBJEKTEVE QË KALOJNË NË FOND BANESE

A. Objektet e ish-shkollës së partisë Laprakë, Tiranë

1. Konvikti nr.1
2. Konvikti nr.2
3. Konvikti nr.3
4. Konvikti i ri
5. Magazina
6. Postblloku

B. Objektet e ish-kombinatit tekstileve të pambukta, Tiranë

1. Zyrat e mirëmbajtjes
2. Reparti ngjyrim fillit
3. Reparti pikanolit
4. Magazina e lëndës së parë
5. Ofiçina e transportit
6. Reparti i vatës
7. Magazina e pjesë këmbimit
8. Magazina e tekstileve të ngjyrosura
9. Magazina e tehzgjahut
10. Impianti i zbutjes së ujit
11. Depoja e ujit, stacioni i pompimit pranë sektorit të zjarrfikësit

C. Objektet e mekanike tekstit, Tiranë

1. Impianti i ftohjes nr.1
2. Impianti i ftohjes nr.2
3. Magazina e detaleve
4. Stacioni i pompimit të ujërave të zeza